



REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI KOMUNËS - SHITIME
Komiteti për Politikë dhe Financa
Nr.01-060/01-15823/21 datë: 05.07.2021



Npi – 01/210 datë: 09.07.2021

Duke u bazuar në nenin 49 dhe 52 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, Nr. 03/L-040; Si dhe në bazë të nenit 3.13 të Rregullores të Punës së Kuvendit dhe Komiteteve, Npi-01/114 të datës: 26.04.2019, Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më: 09.07.2021 nxjerr këtë:

E K S T R A K T
PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË -VII- TË KOMITETIT PËR POLITIKË DHE FINANCA
E mbajtur më datën: 09.07.2021 (e premte) në ora 10.00 h. në sallën Nr.1 të Kuvendit

Në mbledhje kanë marrë pjesë: Kryesuesja znj.Medina Brahaj, pastaj anëtarët e Komitetit z.Perparim Ramusa, z.Naim Zejna, znj.Zarife Rexhaj, z.Ruzhdi Jashari dhe znj.Adelina Beqaj. Përveç anëtarëve të KPF-së në mbledhje kanë marrë pjesë edhe: Drejtorët.

Mbledhjen e hapi, Kryesuesja e KPF-së znj.Medina Brahaj, e cila pasi përshëndeti të gjithë të pranishmit, konstatoi Kuorumin prej 6 anëtarëve prezent në mbledhje, mjaftueshëm për mbajtjen e mbledhjes. Për këtë mbledhje është propozuar ky:

REND DITE

1. Raporti financiar i Komunës për Periudhën Janar-Qershor 2021,
2. Propozim-Vendim për bartjen e mjeteve finan. nga kategoria e rezervës në projekte kapitale,
3. Propozim-Vendim për shpronësimin e pronave në Z.K-Shtime, Petroviç, Reçak, Petrovë,
4. Rishqyrtimi i Statutit të QKMF “Vezir Bajrami” Shtime, Npi-01/150 sipas MPL-së,
5. Rishqyrtimi i Vendimit Npi-01/151 për vendosjen e Shtatores “Adem Jashari” sipas MPL-së,
6. Rishqyrtimi i Vendimit Npi-01/152 për zhvendosjen e Skulpturës “Tri Tytat” sipas MPL-së,
7. Shqyrtimi i Kërkesës të Shoqatës “Jezerci” Komuna – Ferizaj.

Procesverbali Npi-01/210 i datës 09.07.2021

Me kërkesën e Kryesueses së Kuvendit znj.Medina Brahaj, diskutimi për mbledhjen e Komitetit për Politik dhe Financa më 09.07.2021, anëtarëve të KPF-së u është dërguar në formë elektronike në CD-Disc, dhe në formë të tillë e kanë miratuar.

Komiteti për Politikë dhe Financa, në mbledhjen e mbajtur më 09.07.2021, me shumicën e votave miratoi procesverbalet në formë elektronike (CD-Disc) të datave: 01.03.2021, 26.03.2021, 01.06.2021, 22.06.2021, 09.07.2021 dhe 24.08.2021.

Procesmbajtësi:
Idajet Rexhepi



Kryesuesja e KPF
Medina Brahaj